



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.11.2023, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të datave 9, 10 dhe 18 tetor 2023.

1. Diskutimi i kalendarit të punës së komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”

2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Metaj, Ilir Topi, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa dhe Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Flutura Aça, Agron Gjekmarkaj, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Bakiu dhe Oriela Nebijaj.

HAPET MBLEDHJA

Evis Kushi – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik është njoftuar nga sekretaria e komisionit për zhvillimin e mbledhjes së radhës në orën 13:00, por hyrja për në sallën ku zhvillohet mbledhja është bllokuar nga deputetët e opozitës. Një pjesë e deputetëve të mazhorancës arritën të hynin para bllokimit të derës së sallës së mbledhjes, ndërsa pjesa tjetër mbeti pas derës dhe nuk u lejua që të hynte në komision. Për të shmangur konfliktet fizike dhe për shkak se nuk u arrit të bëhej kuorumi me deputetët e mazhorancës që ishin brenda në sallë, mbledhja nuk u zhvillua, por menjëherë pas kësaj ngjarjeje 10 deputetë të mazhorancës, bazuar në nenin 32, pika 2, të Rregullores kanë depozituar një kërkesë, të cilën po jua lexoj.

Ina Zhupa – Për procedurë...

Evis Kushi – Është kërkesa me nr. 340...(ndërprerje e incizimit) të protokollit, datë 7.11.2023, “Për mbledhje komisioni” drejtuar kryesisë së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe, në bazë të kësaj kërkesë, të cilën e keni të gjithë në *e-mail*-et tuaja, kryesia e komisionit njoftoi zhvillimin e mbledhjes *online* bazuar edhe në vendimin nr.17, datë 1.11.2023, të Konferencës së Kryetarëve. Në pikën 4 të këtij vendimi thuhet: “Për shkak të situatës së krijuar në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe organeve të tjera të Kuvendit, mbledhjet mund të zhvillohen *online* me anë të mjetit të komunikimit elektronik të instaluar në Kuvend”. Kështu që, së pari, besoj se verifikojmë kuorumin për të nisur mbledhjen, dhe unë po lexoj emrat e deputetëve...

Ina Zhupa – Me leje?

Evis Kushi – Do t’jua jap fjalën menjëherë pasi të përfundoj. Po vijoj me verifikimin e kuorunit. Flutura Açka? Mungon. Lindita Buxheli? Ju lutem, konfirmoni pjesëmarrjen duke ngritur dorën.

Lindita Buxheli – Këtu!

Evis Kushi – Eduard Ndreca?

Eduard Ndreca – Këtu!

Evis Kushi – Petro Koçi?

Petro Koçi – Këtu.

Evis Kushi – Teuta Ramaj? Nuk arrij t’i kontrolloj dot të gjithë, sepse jam me celular. Teuta Ramaj është e pranishme. Ilir Metaj? Është prezent po ashtu. Ilir Topi?

Ilir Topi – Prezent.

Evis Kushi – Blerina Gjylameti?

Blerina Gjylameti – Këtu.

Evis Kushi – Florenc Spaho?

Florenc Spaho – Prezent.

Evis Kushi – Dasantila Tahiraj?

Dasantila Tahiraj – Po.

Evis Kushi – Enslemvera Zake?

Enslemvera Zake – Prezente.

Evis Kushi – Meri Markiçi? Prezente. Agron Gjekmarkaj? Mungon. Ina Zhupa? Prezente.

Ina Zhupa – Prezente dhe dua fjalën.

Evis Kushi – Andia Ulliri? Mungon. Eralda Bano? Mungon. Kastriot Piroli? Prezent. Merita Baku dhe Oriela Nebijaj? Mungojnë.

Meqenëse e kemi kuorumin, mund të vijojmë me mbledhjen. A jeni të gjithë dakord që ta vijojmë mbledhjen?

Kështu që, bazuar në nenin 23, pika 2, të Rregullores së Kuvendit dhe me kërkesën e më shumë se një të katërtës së deputetëve, në mungesë të kryetares së komisionit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetarja e komisionit. Kështu që ne vijojmë sot me rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Pikë e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 9, 10 dhe 18 tetor të vitit 2023.

Pikë e dytë është diskutimi i kalendarit të punës së komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” dhe pikë e tretë është diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Atëherë, para se t’ia jap fjalën ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për prezantimin e buxhetit, të cilën e falënderoj për pjesëmarrjen, ia jap fjalën zonjës Ina Zhupa për procedurë.

Ina Zhupa – Dëgjohem?

Evis Kushi – Po, dëgjoheni.

Ina Zhupa – Faleminderit!

E para, dua t'ju lajmëroj se jeni duke zhvilluar një mbledhje të paligjshme dhe në mospërputhje me Rregulloren e Kuvendit. Sipas Rregullores së Kuvendit, mbledhjet *online* zhvillohen vetëm kur ka gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme ose gjendje fatkeqësie kombëtare. Vetëm në rast se ju e quani qeverisjen tuaj si fatkeqësi kombëtare, atëherë jeni në të gjithë të drejtën për të vendosur mbledhje *online*, përndryshe jeni në shkelje të Rregullores. Nga ana tjetër, ju e dini fare mirë dhe jeni të ndërgjegjshëm për faktin që opozita parlamentare ka kërkuar, në të drejtën e saj, ngritjen e 3 komisioneve hetimore dhe ndryshimin e përfaqësimit të saj në Komisionin e Reformës Zgjedhore, ashtu siç janë mbi 31 nisma ligjore që mbahen në sirtarët e Parlamentit dhe nuk futen për shqyrtim. Të gjitha këto kanë çuar në atë gjendje, të cilën zonja Kushi e tha pak më parë, që pamundësohej hyrja në Komisionin e Edukimit, sepse, zonja Kushi, është një vendim politik që duhet të marrë nga ju një zgjidhje politike, jo një zgjidhje antiligjore për t'u futur në sisteme *online*, siç nuk e parashikon Rregullorja e Kuvendit. Sot ju mund të fshiheni nga frika përballë kolegëve tuaj, por nuk po u jepni të drejtat kushtetuese dhe një zgjidhje situatës, por vetëm po e agravoni atë, duke çuar në forma të tjera të protestës, të cilat do të përshkallëzohen, për këtë të jeni të sigurt! Ju nuk mund flisni sot, sikur gjithçka është normale dhe ne të diskutojmë sot çështje të kalendarit, të rendit të ditës, çështje të rinisë që po ikën nga vendi apo çështje të tjera të arsimit e të kulturës në ditët në vijim, pasi ju keni mohuar Kushtetutën dhe të drejtat kushtetuese në këtë vend. Ju, kolegët tuaj opozitarë nuk i trajtoni si kolegë deputetë me të drejta kushtetuese, të cilat ua japin Rregullorja dhe Kushtetuta e vendit, por i trajtoni si ndihmësit tuaj, që të mbaroni punët “fap e fap” për të marrë paratë e buxhetit të shtetit, pra ne të jemi thjesht sa për të ngritur kartonët kundër jush. Nëse mendoni se do të shpëtoni nga protestat, duke u fshehur nëpër shtëpi dhe duke hyrë nga ajo dritarja e vogël *online*, më keq se në kohën e Covid-it, i keni bërë llogaritë shumë gabim! Ju jeni, në fakt, pandemia e paligjshmërisë, pandemia e vjedhjeve të buxhetit të shtetit, pandemia e antikushtetueshmërisë, por përsëri kjo nuk e justifikon futjen në një mbledhje *online*, në shkelje të Rregullores. Të gjithë ju jeni deputetë të zgjedhur nga qytetarët dhe do të duhet që, në integritetin tuaj dhe të asaj që përfaqësoni, t'i kërkonit mazhorancës suaj që...

Dëgjohem?

Eduard Ndreca – Zonja Zhupa, dëgjohesh, mund të vazhdosh.

Ina Zhupa – Që t'i ktheheni normalitetit. Besoj se edhe ju e meritoni normalitetin, por edhe buxheti i shtetit do të duhej të trajtohej në normalitet. Dhe normaliteti kthehet, duke zbatuar 3 kërkesat kushtetuese që ne kërkojmë, pa kërkuar asnjë favor dhe asnjë mirësi nga ju, por thjesht

dhe vetëm zbatimin e Kushtetutës. Në qoftë se juve nuk ju duket normale që ne të kemi përfaqësimin tonë në Komisionin e Reformës Zgjedhore, që nismat tona ligjore le të rrëzohen nga ju, por të diskutohen në komisione, që komisionet hetimore të ngrihen sipas një objekti të dakordësuar edhe nga ju, atëherë ju nuk njihni ligj, kushtetutshmërinë dhe për këtë nuk meritoni asnjë respekt.

Kjo ishte ndërhyrja ime për procedurë, dhe, ju lutem, zonja Kushi, të kthehemi në normalitet, të kërkonim zbatimin e 3 kërkesave tona të ligjshme nga mazhoranca juaj; më pas të vijojmë me procedurat normale, duke krijuar mundësinë për të dëgjuar buxhetin dhe të vazhdojmë të japim argumentet tona pro edhe kundër, sipas rastit! Ju nuk mund të fshiheni pas mbledhjeve *online*, pas Gardës së Republikës, duke dhënë urdhra që nuk ekzistojnë askund në ligj, në Kushtetutë dhe në Rregullore. Sot “Linda Garda” është duke bërë masakër dhe terrorizëm parlamentar. Mos u bëni bashkëfajtorë! Kaq kisha.

Evis Kushi – Zonja Zhupa, ju bëni thirrje për t’u kthyer në normalitet, por që të kemi normalitet, kolegët tuaj të opozitës nuk duhet të bllokojnë derën e komisionit; nuk duhet t’i bllokojnë me dhunë deputetët e mazhorancës që të hyjnë në komision; nuk duhet të ngjiten nga kangjellat...

Ina Zhupa – Ju nuk duhet t’i pengoni komisionet hetimore.

Evis Kushi – Ju lutem, sepse unë ju dëgjova!

Ju flisni për paligjshmëri, por paligjshmëri është pengimi me dhunë i deputetëve të mazhorancës që të hyjnë në sallën, ku zhvillohen mbledhjet normalisht...

Ina Zhupa – Paligjshmëri është që të fusni Gardën e Republikës të ndalojë deputetët të hyjnë në zyrat e tyre. Kjo është paligjshmëri.

Evis Kushi – Zonja Zhupa, ju dëgjova dhe po i përgjigjem shqetësimit tuaj. Sot nuk jemi mbledhur këtu për komisionet hetimore, por jemi mbledhur për buxhetin e shtetit dhe, në qoftë se ju nuk e vlerësoni buxhetin e shtetit si një nga ligjet më të rëndësishme...

Ina Zhupa – Ju nuk vlerësoni Kushtetutën. Buxheti duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën! Ju jepni shembullin që zbatoni Kushtetutën dhe më pas të flasim për buxhetin.

Evis Kushi – Zonja Zhupa, ju lutem!

Ju e penguat normalitetin e kësaj mbledhjeje për t’u zhvilluar fizikisht...

Ina Zhupa – Ne kërkojmë normalitetin e Kushtetutës dhe jo normalitetin e “Lindës”.

Evis Kushi – Ju lutem, respektoni kolegët dhe Kryetaren e Kuvendit! Mos flisni me këtë gjuhë, sepse ne, sidomos, duhet të jemi...

Ina Zhupa – Kryetarja e Kuvendit të ketë respekt për deputetët, sepse ka vënë Gardën e Republikës që të na ndalojë për të hyrë në zyrat tona për të bërë mbledhje grupi. Fillimisht duhet të ketë ajo respekt, pastaj të kërkojë respekt.

Evis Kushi – Zonja Zhupa, ju lutem!

Konferenca e Kryetarëve ka vendosur me vendimin nr...

Ina Zhupa – Vetëm e PS-së dhe në shkelje të Rregullores.

Evis Kushi – Faleminderit për deklaratën tuaj! Tani vijojmë mbledhjen. Fjalën e ka ministrja e shtetit për Rininë dhe Fëmijët...

Ina Zhupa – Ju vazhdoni *show*-n. Jeni komplet të paligjshëm.

Petro Koçi – Zonja Kushi, a mund të flas një minutë?

Evis Kushi – Kolegë, më dëgjoni?

Petro Koçi – Ju dëgjojmë, a mund të flas një minutë?

Evis Kushi – Po, zoti Koçi, fjala për ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Së pari, do të kërkoja që teknika e Kuvendit t'ua japë fjalën deputetëve sipas rendit që garantoni ju, përndryshe këtu shkaktohet konfuzion dhe nuk merret vesh se kush e ka radhën për të folur dhe, duke u bërë këto ndërhyrje, bëhet e vështirë për t'u zbardhur e gjithë mbledhja nga specialistët përkatës.

E dyta, nuk mund të na bëjnë moral familjet që marrin tendera nga ky buxhet i shtetit. Ne jemi një komision përgjithësisht me njerëz të ndershëm, por gjithsesi mes nesh ka nga ata që përfaqësojnë familje që përfitojnë tendera nga ky buxhet dhe do t'ju lutesha shumë që këto përgjithësimet e famshme ku një palë na del engjëllore dhe pala tjetër djallëzore, të shmangen dhe të vijojmë normalisht me rendin e ditës!

Dua t'ju kujtoj që, së pari, ne duhet të miratojmë kalendarin, pastaj ta marra fjalën zonja Muzhaqi. Faleminderit!

Evis Kushi – Faleminderit, zoti Koçi, për sugjerimin tuaj!

Po kaloj menjëherë te rendi i ditës. Pikë e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 9,10 dhe 18 tetor. A jemi të gjithë dakord?

Miratohet.

Pikë e dytë e rendit të ditës është diskutimi i kalendarit të punës së komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Të gjithë e keni kalendarin në adresat tuaja të *e-mail*-it, besoj se e keni parë. A jeni të gjithë dakord që ta miratojmë?

Dakord.

Faleminderit!

Miratohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.11.2023, ora 14:30

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Metaj, Ilir Topi, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa dhe Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Flutura Aça, Agron Gjekmarkaj, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Bakiu dhe Oriela Nebijaj.

Të ftuar:

Bora Muzhaqi – ministre e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
Arlinda Topciu – drejtoreshë e Kabinetit të Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
Alqi Kushi – drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Rinisë,
Oltion Pengu – këshilltar i Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
Fregis Sala – këshilltar i Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
Silena Tola – këshilltare e Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Evis Kushi – Viojmë me pikën e tjetër të rendit të ditës: Diskutimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Fjala për ministren për të prezantuar buxhetin, më pas viojmë me pyetjet dhe diskutimet. Zonja Ministre, fjala për ju.

Bora Muzhaqi – Shumë faleminderit, zonja nënkryetare!

Të dashur anëtarë të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, para kësaj mbledhjeje ju është shpërndarë një relacion nga ne, i cili përmban një shpjegim shumë të qartë, qoftë për mbështetjen për rininë, për Agjencinë Kombëtare të Rinisë, për projekte të ndryshme, duke filluar që nga thirrjet e AKR-së, aktivitetet e AKR-së, për programet që kemi në zbatim në Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor, për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, Strategjinë Kombëtare të Rinisë, por gjithashtu edhe programet që ne zbatojmë në bashkëpunim me ministrinë e linjës, siç janë programet e ekipeve sportive, programi jashtë orarit mësimor, programi i kodimit për të rinjtë dhe programi i kodimit në shkolla. Megjithatë, me qëllim qartësimin dhe shpjegimin e mëtejshëm të buxhetit, do t’ju kaloj shkurtimisht të gjitha materialet që kemi përgatitur për t’ju bërë një panoramë sa më të qartë të punës sonë, por edhe se çfarë planesh kemi për vazhdueshmërinë gjatë vitit 2024.

Siç besoj që jeni në dijeni, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka si detyrë funksionale hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shkollimin, shëndetin, mirërritjen dhe miredukimin e fëmijëve. Nga ana tjetër, i vetmi entitet zbatues, që është nën varësinë e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, është Agjencia Kombëtare e Rinisë, e cila ka si mision kryesor garantimin, promovimin e të drejtave dhe detyrimeve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimit dhe aktivizimit të rinisë, financimit të veprimtarive rinore në bazë dhe në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e Agjencisë Kombëtare të Rinisë shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke organizuar përgjegjësitë funksionale, me qëllim sigurimin e kushteve për

mbështetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore, si dhe mbështetjen e programeve dhe projektpropozimeve të organizatave rinore dhe për të rinjtë, të cilat kanë në fokus rininë shqiptare dhe fuqizimin e krijimin e mundësive për ta. Kjo Agjenci është krijuar që në vitin 2020, por më 26 tetor të vitit 2022 ne miratuam me vendim të Këshillit të Ministrave Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe planin e veprimit për këtë strategji. Sigurisht që qëllimet dhe masat e strategjisë janë parashikuar të zbatohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Sigurisht që projektbuxheti është hartuar në korrespondim me të gjitha ligjet e nevojshme për menaxhimin e sistemit buxhetor, si dhe me të gjitha udhëzimet përkatëse, por, nga ana tjetër, janë marrë parasysh edhe të gjitha kërkesat shtesë që kanë të bëjnë me Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe me zbatueshmërinë e tyre për vitin 2024, sepse ky është edhe dokumenti ynë kryesor sa u përket politikave për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve.

Më konkretisht, në projektbuxhetin për vitin 2024, për Agjencinë Kombëtare të Rinisë janë planifikuar 215 milionë e 954 mijë lekë si mbështetje për rininë, përkatësisht në zërin 08610 të buxhetit, të cilat do të zbatohen nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Ky zë buxhetor ndahet në dy komponentë: në shpenzimet korente, që janë në vlerën 165 milionë e 954 mijë lekë, të cilat përfshijnë zërat për shpenzime operative, si: paga, sigurime, utilitete, por, gjithashtu, pjesa më e rëndësishme është mbështetja me grante për projektpropozimet nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, në kuadër të thirrjes së katërt për to.

Nga ana tjetër, kemi dhe shpenzimet kapitale, që janë në vlerën 50 milionë lekë, ku parashikohet përmirësimi i infrastrukturës rinore përmes granteve që u jepen njësive të vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet thirrjeve të hapura për mbështetje me investime për rishturimin, ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, duke përfshirë këtu qendrat rinore, bibliotekat apo hapësirat për të rinjtë.

Lajmi i mirë është që projektbuxheti i vitit 2024 reflekton një rritje prej 33% krahasuar me buxhetin e vitit 2023 dhe një rritje prej 34% krahasuar me buxhetin e vitit 2022, duke krijuar kështu mundësinë që të zbatohet të gjitha angazhimet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë për vitin 2024 lidhur me detyrat funksionale që ka Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Sa u përket këtyre detyrave, ato janë në përputhje me ligjin “Për rininë”, por edhe me VKM-në që ka ngritur dhe themeluar Agjencinë Kombëtare të Rinisë. Detyrat kryesore lidhen me mbështetjen e aktorëve që ofrojnë shërbime për të rinjtë, duke filluar nga mbështetja e

projektpropozimeve nga organizatat rinore dhe për të rinjtë, por edhe mbështetja për ndërhyrje në infrastrukturën rinore, duke përfshirë të gjitha hapësirat e nevojshme për të rinjtë e qyteteve tona.

Patjetër që kjo pjesë thelbësore e këtij buxheti, këtu flasim gjithmonë për shpenzimet korente, që i referohen pjesës së mbështetjes për organizatat rinore dhe shpenzimet kapitale janë ato që i referohen pjesës së infrastrukturës, lidhet me investimet kapitale që bëjmë në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Një komponent i rëndësishëm, që vlen për t'u theksuar, është edhe menaxhimi i këtyre projekteve dhe mënyra se si bëhet përzgjedhja e projekteve nga ana e Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Gjatë vitit 2022, pas përfundimit të miratimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë, ne menduam se ishte momenti të ndryshonim dhe metodologjinë e përzgjedhjes dhe thirrjes se si zhvillohej ajo nga ana e AKR-së. Pasi vlerësuam disa sisteme, sipas kriterëve dhe standardeve që kërkohen nga Bashkimi Europian, në bashkëpunim me UNDP-në, më 11 mars të vitit 2022 ne nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi për t'i hapur rrugë një procesi, i cili kishte si synim rishikimin e mekanizmit në zbatim për menaxhimin e granteve shtetërore për rininë, bazuar në metodologjinë LOD, të cilën jam e bindur se e njihni; është një nga praktikat më të suksesshme të Bashkimit Europian për financimin e organizatave të shoqërisë civile, por edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që siguron transparencë, efektivitet dhe gjithëpërfshirje në çdo hallkë të këtij procesi.

Ne kemi realizuar përshtatjen ligjore dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe për të rinjtë që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë, duke reflektuar kështu dhe praktikat më të mira të Bashkimit Europian lidhur me agjencitë shtetërore.

Bazuar në këtë metodologji, kemi zbatuar dy cikle thirrjesh për grante nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, përkatësisht në vitin 2022 dhe në vitin 2023, dhe ky proces ka arritur besueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile, me fokus tek organizatat për të rinjtë dhe organizatat rinore, në sajë të transparencës që ofron, si dhe në sajë të përfshirjes së aktorëve nga shoqëria civile në procesin e vlerësimit të projektpropozimeve, duke e bërë shoqërinë civile pjesë të çdo procesi.

Gjithashtu, me anë të përshtatjes së legjislacionit, të kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe për të rinjtë, me direktivat dhe metodologjitë që kanë

Bashkimi European dhe OKB-ja, kemi mundësuar rritjen e kapaciteteve të të gjithë shoqërisë civile, me qëllim qasjen më të mirë të tyre në fondet e Bashkimit European, që janë në dispozicion për këtë target-grup.

Nga ana tjetër, kemi realizuar dhe një rritje të kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, për ta kthyer në një entitet dhe në një agjenci që nuk është ekskluzivisht e varur vetëm nga buxhetet e vendosura në dispozicion nga shteti, por që ka edhe akses në fondet e Bashkimit European.

Meqenëse përmendëm thirrjet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, do të doja të ndalesha goftë tek thirrjet që kanë filluar realizimin gjatë vitit 2022 dhe janë shtrirë në vitin 2023, por edhe tek ato që kanë filluar në 2023-shin dhe do të vijojnë shtrirjen e tyre dhe gjatë vitit 2024.

Për sa i përket thirrjes së dytë për rininë, janë financuar 23 projektpropozime rinore, në vlerën 58 milionë lekë dhe një prej këtyre projektpropozimeve është mbështetur nga UNICEF-i, në vlerën 3,5 milionë lekë. Gjithashtu, janë realizuar dhe 5 projekte të infrastrukturës rinore në 5 bashki, në vlerën 50 milionë lekë, ku të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë bashkëfinancuar projektpropozimin me të paktën 10% të shumës së financimit të kërkuar nga AKR-ja. Pra, në total, buxheti i investuar për këtë pjesë ka arritur në 108 milionë lekë.

Ndërkohë, dua t'ju përmend specifikisht edhe projektet që ne kemi realizuar, pra nëpërmjet 24 projekteve në total, 23 të financuara nga buxheti i shtetit dhe 1 i financuar nga buxheti i UNICEF-it, kjo falë rritjes së transparencës dhe eficiencës në projektthirrjet që ne kemi realizuar. Kanë përfutur në mënyrë të drejtpërdrejtë 7000 të rinj në 25 bashki të vendit. Sigurisht, bashkitë janë të shpërndara në të gjithë territorin shqiptar, duke filluar nga: Devolli, Bulqiza, Tirana, Korça, Shkodra Elbasani, Vlora, Durrësi, Kavaja, Gjirokastra, Saranda, Lushnja, Fieri, Rogozhina, Mati, Tepelena, Berati, Pogradeci, Puka, Fushë-Arrëzi, Kamza, Vau i dejës, Skrapari, Maminasi dhe Konispoli. Pra, 20 projektet e para kanë pasur shtrirje në këto bashki që sapo përmenda (në total 25 bashki) dhe, nga ana tjetër, kemi pasur dhe 3 projekte me shtrirje kombëtare më pjesën më të madhe të bashkive.

Dua të ndalem pak edhe te pjesa e ndërhyrjeve në infrastrukturën rinore në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku, më konkretisht, në Durrës jemi duke rikonstruktuar Qendrën Rinore Multifunktionale; në Gjirokastrë, me anë të projektit “Try Gjirokastra”, jemi duke krijuar një qendër multifunktionale me shërbime për të rinjtë; në Lushnjë kemi inauguruar bibliotekën e re dhe krijimin e klubeve të leximit; në Dibër kemi investuar për një bibliotekë të re, që është kthyer

në një qendër multifunksionale dhe rekreative dhe në Kamëz është krijuar tashmë biblioteka e re dhe salla e të rinjve brenda Pallatit të kulturës. Arsyeja pse i përmenda këto 5 projekte është se, me anë të tyre, kanë akses të drejtpërdrejtë dhe përfitojnë 106 mijë e 882 të rinj.

Kur flasim për thirrjen e tretë, kemi pasur po të njëjtën trajektore për sa i përket për zgjedhjes së projekteve, por kemi shtuar një kusht të ri: angazhimin e bashkive më të vogla, më qëllim shtrirje e mëtejshme të programeve tona.

Nga kjo thirrje po financohen 23 projekte rinore, por, në ndryshimi nga viti i parë, ku kishim vetëm UNICEF-in si donator të jashtëm, në këtë rast e kemi shtuar listën e donatorëve dhe kemi pasur dhe një mbështetje shumë të madhe, pra 3 projekte janë mbështetur nga UNICEF-i, UNDP-ja dhe UNFPA-ja, ndërkohë që 20 projekte janë mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, me një vlerë totale prej 58 milionë lekësh.

Shtrirja gjeografike e këtyre projekteve fituese në thirrjen e tretë përfshin 40 bashki, të cilat nuk po i rendis, por jam e bindur që, nëse dikush prej ka kuriozitet, ato gjenden të gjitha në relacionin dhe në raportin që ne kemi dorëzuar dhe kanë pasur një shtrirje më të gjerë gjeografike sesa thirrja e dytë që ne kemi realizuar me Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Patjetër që AKR-ja, meqenëse pjesa më e madhe e buxhetit shkon për sa u përket projektpropozimeve, ka edhe detyra të tjera, që zhvillohen në terren, duke folur kështu për edukimin joformal apo për aktivitetet e ndryshme që kanë për qëllim fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e më shumë oportuniteteve qoftë për trajnimin e tyre, zhvillimin e kapaciteteve apo aftësitë e buta, siç janë aftësitë e *leadership*-it apo të komunikimit. Më konkretisht, një nga objektivat specifikë të Strategjisë Kombëtare të Rinisë lidhet me pjesën e informimit. Në objektivin specifik 1.1 të Strategjisë Kombëtare të Rinisë thuhet: “Të rinjtë janë të mirinformuar rreth mundësive për të mësuar, për të fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, por edhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike”.

Për të realizuar këtë masë shumë të rëndësishme të Strategjisë Kombëtare të Rinisë ne kemi realizuar 5 panaire edukimi, trajnimi dhe punësimi, me qëllim informimin e të rinjve në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Më konkretisht, panairët janë zhvilluar në Kukës, në Sarandë, në Vlorë, në Shkodër dhe në Tiranë. Në total, për të gjitha këto panaire kemi pasur mbi 100 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinjtë, të cilët kanë prezantuar ofertën e tyre për të rinjtë, dhe të rinjtë kanë pasur mundësinë të njihen me mundësitë, shërbimet, ofertat lokale për nxitjen e pjesëmarrjes aktive në qytet, por edhe janë njohur me mundësitë kombëtare, pra me të gjitha programet që ne zbatojmë

për ta, duke filluar nga programi i praktikave të punës, programi i kodimit apo programet e ndryshme të *internship*-it apo trajnimeve që ne zhvillojmë. Më konkretisht, kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë edhe me zyrat e institucioneve, duke filluar nga zyrat e punës dhe të aftësisimit në çdo qytet, por kemi pasur dhe përfaqësi të ministrive të linjës, duke filluar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që na ka mbështetur me mundësitë për të rinjtë në pjesën e hidrocentraleve, aeroporteve, aviacionit civil, OSHEE-ja dhe, nga ana tjetër, kemi pasur Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me skemat e mbështetjes për fermerët dhe me skemat për fermerët e rinj. Ndërkohë, kemi pasur Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me agjencitë për zonat e mbrojtura dhe, patjetër, në çdo panair kemi pasur dhe Ministrinë e Mbrojtjes, me anën e Forcave të Armatosura, të cilat kanë promovuar skemat për çdo të ri që ka dëshirë t'u bashkohet Forcave të Armatosura. Nuk jemi ndalur vetëm tek institucionet shtetërore, kemi pasur përfaqësi shumë të mira edhe nga bizneset, qofshin këto biznese lokale, të fushave të artizanatit, të bujqësisë, hoteleri-turizëm apo edhe industri ushqimore. Sigurisht, thelbi ka qenë ndërlidhja e të gjithë aktorëve, duke filluar nga universitetet, bizneset lokale, institucionet, por edhe donatorët e ndryshëm që na janë bashkuar, siç mund të jenë “*praktika.al*”, *Swisscontact*, ambasada britanike dhe ambasada amerikane.

Për t’jua thënë shkurtimisht dhe vetëm me shifra, në Kukës kemi pasur 25 aktorë pjesëmarrës dhe 150 të rinj, të cilët janë informuar mbi mundësitë e ndryshme që ne kemi; në Sarandë kemi pasur 30 aktorë pjesëmarrës me 100 të rinj që kanë përfituar nga ky panair; në Vlorë kemi pasur 40 aktorë pjesëmarrës dhe mbi 500 të rinj që janë bërë pjesë e aktivitetit; në Shkodër 40 aktorë pjesëmarrës dhe 400 të rinj të informuar; në Tiranë 50 aktorë pjesëmarrës dhe mbi 500 të rinj. Ky është vetëm fillimi i këtij programi, sepse në muajt e ardhshëm, por edhe përgjatë vitit 2024 ne do të vijojmë t’i zhvillojmë këto panire. Plani është që gjatë këtij viti të zhvillojmë panire në Korçë, në Dibër dhe në Gjirokastër gjatë periudhës nëntor-dhjetor dhe në fillim të vitit të ardhshëm do të rikthehemi në Durrës, në Elbasan, në Lezhë, në Berat dhe në Fier, me qëllim që t’i përmbyllim në të gjitha qarqet e Shqipërisë, për të qenë më pranë të rinjve për mundësitë që ata kanë qoftë për edukim, qoftë për punësim apo për trajnime të ndryshme.

Patjetër që, kur flasim për rininë, pjesë e politikëbërjes dhe e angazhimit të tyre me çdo politikë që ne ndërmarrim është shumë e rëndësishme, prandaj dhe vlerësimi i Strategjisë Kombëtare të Rinisë nuk kryhet vetëm nga institucionet, por kryhet edhe nga vetë të rinjtë. Me këtë qëllim, këtë verë kemi realizuar Rin Camp –in, ku morën pjesë 100 të rinj nga qytete të

ndryshme të Shqipërisë, të cilët përgjatë kampit u njohën me perspektivat dhe përvojat e 26 panelistëve të ndryshëm, të cilët folën për tranzicionin në tregun e punës dhe për risitë e ndryshme të këtij tregu, për digjitalizimin, për kërkimin shkencor, për pjesën e strukturave vendore rinore, por edhe për aftësitë e *leadership*-it dhe aftësitë ndërpersonale. Mbi të gjitha, në këtë trajnim u diskutua edhe se si mund të monitorohet Strategjia Kombëtare e Rinisë nga jashtë, pra që vetë të rinjtë të jenë kontributorët të cilët të vendosin nëse një strategji është zhvilluar mirë, nëse një masë është zbatuar apo ka ende nevojë për t'u zbatuar.

Kemi pasur edhe aktivitete të mëtejshme, por një nga aktivitete që vlen të theksohet është edhe pjesëmarrja në *Albania Code Weak Hackathon*, pra *hackathon*-a e parë ku të rinjtë patën mundësi të mësojnë se si të kodojnë në një kohë të shkurtër dhe të zgjidhin problematika të fushave të rëndësishme për vendin tonë, duke filluar nga arsimi, transporti, turizmi, mbrojtja dhe ruajtja e ambientit dhe shumë tema të tjera të rëndësishme për vetë të rinjtë.

Folëm pak për pjesën e thirrjeve, por një komponent i rëndësishëm, i cili do të jetë subjekt edhe për investimet e vitit të ardhshëm, lidhet me fuqizimin e të rinjve, pra me këto struktura vendore ku të rinjtë kanë mundësinë e të qenit bashkëveprues për sa u përket politikave lokale. Kur flasim për ngritjen e këshillave vendorë rinorë, jo më larg se vitin e shkuar ne kishim të ngritur 42 këshilla vendorë rinorë, pra përfaqësi të rinjsh që funksionojnë si etnitete konsultuese pranë anëtarëve të bashkisë. Sot që flasim nuk janë më 42, por janë 59 këshilla vendorë rinorë, të cilët janë ngritur dhe janë funksionalë; mbeten ende dy, të cilët janë në proces ngritjeje dhe besojmë se shumë shpejt do të kemi një strukturë mirëfunksionale për të gjitha bashkitë e vendit, nga cepi më jugor në cepin më verior. Patjetër që është e thjeshtë t'i ngresh në letër këta këshilla vendorë rinorë, por pjesa e vështirë lidhet me funksionalizimin e tyre dhe me bërjen efektive të punës që ata kryejnë. Pikërisht për këtë arsye ne zhvillojmë aktivitete të shumta gjatë vitit, me qëllim rritjen e kapaciteteve qoftë të vetë të rinjve që janë të angazhuar në këta këshilla vendorë rinorë, por edhe të punonjësve rinorë pranë bashkive.

Për këtë arsye, vitin e shkuar, në dhjetor, por edhe këtë vit do të zhvillojmë të njëjtin aktivitet; është Shkolla Dimërore që ne realizojmë për punonjësit rinorë të bashkive, ku ata mësojnë kapacitete të nevojshme qoftë për pjesën e menaxhimit të kërkesave dhe dëshirave që kanë të rinjtë, se si ato mund të bëhen pjesë e buxheteve lokale që bashkitë realizojnë në përditshmërinë e tyre, por komponenti më i rëndësishëm është shkrimi i projekteve. Sigurisht, bashkitë aplikojnë në institucione të ndryshme shtetërore për projekte që kanë lidhje me zhvillimin

infrastrukturor të qyteteve të tyre, por pjesa tjetër dhe më e rëndësishmja janë aplikimet në Bashkimin Europian, që, sigurisht, kërkon një rritje të kapaciteteve dhe është edhe aftësi shumë më e madhe në shkrimin e projekteve, prandaj edhe të gjitha kampet që ne realizojmë për të gjitha eventet dhe trajnimet që kryejmë me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, kanë një fokus të veçantë për sa i përket shkrimit të projekteve, me qëllim rritjen e kapaciteteve qoftë të vetë të rinjve, por edhe të atyre që punojnë me të rinjtë përditë.

E fundit, për sa i përket fuqizimit, është edhe Këshilli Kombëtar Rinor, i cili është ngritur në kohën e nënkryetares dhe ky ka qenë Këshilli i parë Kombëtar Rinor, por tashmë mbaroi mandati i parë dhe ne kemi realizuar në mënyrë shumë të shpejtë, pa krijuar boshllëqeve, ngritjen e dytë të Këshillit Kombëtar Rinor, i cili është tashmë efektiv dhe sot pikërisht do të ishte dita që do të zhvillonim takimin e parë, por e kemi shtyrë për shkak të kësaj mbledhjeje të komisionit. Besoj se shumë shpejt ky këshill do të jetë funksional dhe do të ketë mundësinë të veprojë si një entitet konsultues i politikave qendrore që zhvillojmë për të rinjtë. Në çdo rast kemi një angazhim të të rinjve qoftë në nivel lokal, kur flasim për këshillat vendore rinorë, qoftë në nivel kombëtar, kur kemi rastin e Këshillit Kombëtar Rinor. Kjo është për sa i përket fuqizimit të të rinjve, por një komponent i rëndësishëm për sa i përket buxhetit të vitit të ardhshëm, janë edhe dy programet e BE-së që presim të jenë të zbatueshme nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë. I pari lidhet me “*EU for Youth*”-in ose i ashtuquajtur ndryshe “Programi BE-ja për Rininë”, që është një nga projektet e IPA 2023 dhe si fusha, prioritete tematike, ka politikat arsimore, punësimin, mbrojtjen sociale, politikat gjithëpërfshirëse dhe shëndetësinë. Ky është një projekt, i cili do të zbatohet nga 3 institucione, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Më konkretisht, janë 3 fasha të mbështetjes që vijnë nga ky program me një vlerë totale prej 5 milionë eurosh, që do të shkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për të rinjtë në këto 3 fusha specifike që përmenda.

E para lidhet me pjesën e pjesëmarrjes qytetare të të rinjve, pra lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me këshillat vendorë dhe me Këshillin Kombëtar Rinor. Ky do të jetë edhe një nga fokuset kryesore që do të ketë Agjencia Kombëtare e Rinisë për vitin 2024.

Fusha e dytë lidhet me arsimin dhe punësimin e të rinjve të grupeve vulnerabël. Kjo lidhet drejtpërdrejt me garancinë rinore, që është një tjetër projekt pilot i cili do të zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë për të gjithë ata të rinj që nuk janë në arsim në trajnim apo në punësim.

Fusha e tretë është një fushë e rëndësishme, e cila do të zbatohet nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, dhe lidhet me aftësitë e shekullit 21 dhe këshillimin në karrierë për nxënësit e shkollave, një komponent i rëndësishëm, i cili çdo ditë me ndryshimet e tregut të punës bëhet edhe më relevant për t'u diskutuar me të rinjtë tanë.

Folët pak më parë për garancinë rinore, i cili, ndonëse do të zhvillohet pjesërisht me projektin "BE-ja për rininë", vitin e ardhshëm do të zhvillohet edhe si një program i mirëfilltë i BE-së, i cili do të ketë një mbështetje shumë të madhe qoftë nga fondet e BE-së, por edhe nga niveli organizativ. Kur flasim për garancinë rinore, komponent e këtij programi janë 3: punësimi rinor; arsimi profesional dhe trajnimi, por edhe mbështetje të tjera teknike për hartimin e planit operacional lidhur me mënyrën e zbatimit të këtij programi. Presim që shumë shpejt të jemi të angazhuar edhe me këtë program dhe të fillojmë lançimin e mirëfilltë të tij.

Ndërkohë, një tjetër detyrim ligjor për sa i përket pjesës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë është edhe bashkëpunimi, kuota e anëtarësimit në Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor, ose e njohur ndryshe si *RYCO*, ku kemi pasur një angazhim shumë të madh. Ajo që vlen për t'u përmendur është se që nga themelimi i *RYCO*-s ky ka qenë viti i parë që Shqipëria ka marrë kryesimin e bordit të *RYCO*-s, ku unë jam si përfaqësuese e qeverisë. Nga ana tjetër, kemi edhe një përfaqësues rinor. Këtu vlen për të theksuar se, në ndryshim nga shtetet e tjera, ku ky përfaqësues rinor zgjidhet duke u emëruar nga ana qeveritare, në rastin tonë ky përfaqësues rinor është zgjedhur me votime të drejtpërdrejta nga organizatat rinore dhe ka pasur një transparencë të plotë duke siguruar që ne të kemi një përfaqësi të denjë të të rinjve tanë në këtë bord.

Nëse flasim për të gjitha produktet që realizon *RYCO*, përveçse është një produkt konkret i Procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor, ka pasur edhe një sërë aktivitete, duke filluar që nga Forumi Rinor i Ballkanit Perëndimor. Nga ky rajon u mirëpritën në Shqipëri 90 të rinj, të cilët diskutuan për demokracinë, paqen, sigurinë gjithëpërfshirëse, por edhe jetesën e qëndrueshme. Fokusi i këtij forumi është të nxjerrë një deklaratë, e cila i përcillet samitit të liderëve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim adresimin e çështjeve dhe problematikave që vetë të rinjtë identifikojnë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë, një lajm i mirë është edhe hapja e Fondit Kulturor të Rinisë në Ballkanin Perëndimor, i cili nuk do të jetë një financim nga vendet e Ballkanit Perëndimor, por është një financim i qeverisë gjermane në vlerën 300 mijë euro dhe do të jenë gjithsej 10 thirrje që do të zhvillohen me anë të këtij fondi kulturor dhe do të kenë akses për herë të parë, jo vetëm organizatat rinore dhe organizatat që punojnë me të rinjtë, por do të kenë edhe

vetë të rinjtë si individë apo ata që funksionojnë si grupe joformale, duke kaluar në vlera nga 1 mijë euro për ata që janë individë, 3 mijë euro për ata që janë grupe joformale dhe më tej 6 mijë euro për organizatat rinore. Kjo do t'u japë jetë të gjitha ideve kreative që kanë të rinjtë shqiptarë, sigurisht edhe në bashkëpunim me të rinjtë e rajonit.

Një tjetër program që kemi zbatuar në mënyrë të suksesshme me RYCO-n është edhe programi “Supershkollat”, i cili është hapur për herë të parë në vitin 2022. Atë vit kishim vetëm 60 shkolla përfituese, ndërkohë që numri i shkollave në vitin e dytë, pra në vitin 2023, u rrit nga 60 në 100 shkolla, duke krijuar kështu mundësinë që mbi 800 nxënës dhe rreth 120 mësues të përfitonin nga shkëmbimet që u kryen midis shkollave në Shqipëri dhe në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor për të pasur edhe ata eksperiencën për ndërtimin e një procesi të drejtuar nga vetë të rinjtë. Kjo është për sa i përket RYCO-s.

Një tjetër program që kemi është Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, i cili ka vijuar për rreth 7 vjet. Ky është viti i 8-të që vijon të zbatohet në mënyrë të suksesshme në bashkëpunim me institucionet shtetërore, me shoqëritë tregtare, gjithashtu edhe me bashkitë dhe me institucionet e pavarura.

Këtu kemi rezultate shumë të mira. Ky vit është ende në proces thirrjeje dhe besoj që më 1 dhjetor do të përfundojë edhe kohorta e këtij viti për praktikantët dhe, si zakonisht, ata që rezultojnë të suksesshëm e që marrin pikët maksimale në institucionet ku punojnë, do të kenë mundësi të fillojnë edhe kontratat e tyre me kohë të plotë pranë institucioneve ku kanë kryer praktikën.

Nëse flasim për Strategjinë Kombëtare të Rinisë, kemi plot detyra që do të duhet të zhvillojmë gjatë vitit të ardhshëm, duke filluar që nga rishikimi i ligjit “Për rininë” apo rishikimi i ligjit “Për vullnetarizmin”, të cilat janë në detyrat funksionale që ne do të vazhdojmë të zhvillojmë gjatë vitit të ardhshëm.

Ndërkohë, duke e ditur që kemi shumë programe dhe duke ditur që edhe koha juaj është e limituar, po ju përmend shkurtimisht programet që kemi në bashkëpunim me ministrinë e tjera. Nëse do të ketë pyetje, jam në dispozicion për t'ju kthyer përgjigje qoftë për shtrirjen gjeografike apo shtrirjen e këtyre programeve.

Vitin e kaluar kemi zhvilluar programin e ekipeve sportive dhe plani është të vijojmë me të njëjtat ritme edhe për këtë vit.

Nga ana tjetër, kemi zhvilluar programin jashtë orarit mësimor që do të jetë një program, i cili do të vijojë edhe në vitin e ardhshëm.

Për sa i përket kodimit, po ndalem shkurtimisht te programi i kodimit për të rinjtë. Vitin e kaluar, kur folëm në këtë komision, jua lançova këtë nismë të re, e cila ndoshta u prit me pak skepticizëm, por, edhe pse programi ka filluar më 23 janar të këtij viti dhe ne kishim premtuar që do të kishim 1 mijë kodues në fund të vitit 2023, në realitet, pa u mbyllur ende viti, kemi 1 068 kodues. Kjo do të thotë se premiset janë pozitive dhe deri në fund të vitit do ta tejkalojmë shifrën e koduesve që ishim angazhuar për ta realizuar gjatë këtij viti.

I fundit, por jo nga rëndësi, është programi i kodimit për fëmijët. E kemi filluar në disa shkolla dhe tani dëshirojmë ta shtrijmë në 200 shkolla të tjera, me qëllim zhvillimin e këtij programi në klasë të parë, por edhe në klasat e tjera të mëvonshme.

Kjo është një panoramë deri diku e shkurtër e të gjithë punës dhe të gjitha planeve për vitin 2024, por mbetem në dispozicion për çdo pyetje të mëtejshme që mund të keni.

Shumë faleminderit!

Evis Kushi – Zonja Muzhaqi, shumë faleminderit për këtë prezantim të hollësishëm të projektbuxhetit për vitin 2024 bashkë me projektet, objektivat dhe të gjitha aktivitetet që keni parashikuar për rininë dhe fëmijët!

Hapim seancën për pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Kush e do fjalën?

Ka pyetje?

Zonja Buxheli.

Lindita Buxheli – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Faleminderit ministres edhe për të gjithë prezantim e saktë dhe të qartë që i bëri projektbuxhetit të vitit 2024!

Gjej rastin ta falënderoja ministren për mbështetjen që tregoi për qytetin që përfaqësoj, Lushnjën, nëpërmjet shumës prej 10 milionë lekësh për Agjencinë e Rinisë, duke qenë bashkëfinancuese me Bashkinë e Lushnjës, për ta bërë bibliotekën e qytetit një ndër ndërtesat më të bukura në qytet, të cilën ju ftoj ta vizitohet së shpejti.

Pyetja ime është: këtë vit sezoni turistik njohu një bum të jashtëzakonshëm, për të cilin të gjithë jemi dëshmitarë, duke nxjerrë para nesh sfidën për njerëz të kualifikuar. Kjo do të thotë se këtë kishim më shumë nevojë për elektrikistë, hidraulikë, riparues të makinave e të tjerë, për shkak të atij fluksi, i cili sjell nevojën dhe domosdoshmërinë e drejtimit të të rinjve tek arsimi profesional. Ju folët këtu për këshillimin e karrierës, konkretisht sot në Lushnjë kemi rreth 6 mijë nxënës të

arsimit 9-vjeçar. Ju e prekët këtu, por doja të dija diçka më shumë, për këta 5900 nxënës të klasës së 9-të, sepse dihet që jo të gjithë mund të vazhdojnë gjimnazin, konkretisht çfarë keni parashikuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit në këtë drejtim?

Faleminderit!

Evis Kushi – Faleminderit, zonja Buxheli!

Fjala për zonjën ministre për t'u përgjigjur.

Bora Muzhaqi – Shumë faleminderit për pyetjen!

E para, jemi shumë të gëzuar që biblioteka është gjallëruar nga të rinjtë dhe besoj se do të jetë një vend ku të rinjtë do të mund të takohen dhe do të kenë hapësirën e tyre. Besoj se edhe fëmijët do ta përdorin këtë bibliotekë të re. Kur fillon nga dija, nga librat, patjetër që edhe komponentët e tjerë bëhen më të thjeshtë.

Për sa i përket pjesës së arsimit profesional, dy komponentë janë ata që do të doja të përmendja: fushatën që është zhvilluar nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Arsimit, që quhet “Zgjidh zanatin”. Synimi kryesor i kësaj fushate është të targetojë të rinjtë, të cilët ndoshta nuk e kanë ndarë ende karrierën e tyre dhe mund të kenë menduar që ndjekja e një gjimnazi të përgjithshëm është zgjedhja e tyre për të ardhmen, në fakt mund të jenë më të prirur për zanatet ose për profesione të ndryshme. Në këtë rast jemi duke bërë një këshillim karriere të mirëfilltë qoftë nga ekspertët nëpër institucionet tona arsimore, por edhe nga vetë drejtuesit e institucioneve, me qëllim që të rinjtë që mendojnë se profesioni dhe zanati mund të jetë fusha e tyre e përzgjedhur, të kenë mundësi të kalojnë. Pra, praktikisht edhe për këtë vit (është mirë që edhe prindërit ta kuptojnë, ta dinë këtë pjesë) të gjithë të rinjtë dhe fëmijët që janë regjistruar në gjimnaze në vitin e parë deri në fund të këtij semestri, pra deri në dhjetor të këtij viti, do të kenë mundësinë të kalojnë në arsimin profesional, nëse kanë vendosur që kjo është zgjedhja e tyre. Ky lehtësim që është bërë, krijon mundësinë që vetë nxënësit të mund të zgjedhin dhe të kalojnë në mes të vitit, që është diçka që nuk ka ndodhur më parë. Synimi në këtë rast është që ne të kemi mundësi t'i adresojmë të rinjtë drejt shkollave profesionale.

E dyta, e përmenda pak gjatë fjalës sime, lidhet me garancinë rinore. Programi i garancisë rinore, që zbatohet ngushtësisht me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, lidhet drejtpërdrejt me arsimin profesional dhe arsimimin e mëtejshëm të të rinjve, nga mosha 15 vjeç - 29 vjeç. Për të gjithë ata të rinj që nuk e kanë gjetur ende punën e tyre apo arsimin e tyre ne do të ofrojmë si qeveri një garanci ose për një trajnim të mëtejshëm profesional, ose për arsim të mëtejshëm, ose punësim.

Këtu është edhe pjesa e praktikave, por edhe pjesa e profesioneve të artizanatit apo profesionet siç i përmendët: elektrikist, hidraulik, hoteleri-turizëm e të tjera, pra të gjithë komponentët e profesioneve manuale. Në të dy komponentët jemi duke zhvilluar gjithçka.

E treta, për të cilën ndoshta ju jeni në dijeni, lidhet me pjesën e këshillimit të karrierës. Duke filluar nga janari i këtij viti, në të gjitha shkollat që në klasën e 9-të fillon këshillimi i karrierës. Nëse më herët zhvillohej në gjimnaz, tani zhvillohet në klasën e 9-të dhe, nga të gjitha analizat që kemi kryer për vlerësimin e situatës, mendojmë se mund ta fillojmë edhe më herët. Ajo për të cilën punojnë kolegët e Ministrisë së Arsimit, sigurisht në bashkëpunim të ngushtë, është edhe mundësia që këshillimi i karrierës të fillojë nga bërthama, të cilat përbëhen nga entitete të ndryshme brenda shkollës, dhe të mund të zhvillohet që në klasën e 6-të, të 7-të apo të 8-të për të krijuar kështu mundësinë që ata të kuptojnë që, nëse arsimi profesional është dëshira e tyre, të mund ta zgjedhin që në fazën më të hershme.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjala për zotin Koçi!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Së pari, dua ta vlerësoj prezantimin e buxhetit dhe të politikave për rininë dhe fëmijët nga ministrja Muzhaqi! Ishte një shpjegim shumë i detajuar, që besoj është bindës për të gjithë anëtarët e këtij komisioni për ta mbështetur buxhetin e këtij sektori, ku përfshihen rinia dhe fëmijët.

Dua të them diçka, që është më shumë një lloj sugjerimi, i cili më shumë sesa për buxhetin lidhet me politika, nisur nga parimi që përgjithësisht më bindëse është vepra sesa fjala, pra edhe për ne si parlamentarë ose si politikanë më e rëndësishme është ajo që bëjmë, jo aq ajo që themi. Çfarë dua të them me këtë?! Dua të them që modeli është mënyra më e mirë për t'i edukuar të rinjtë e sotëm drejt një karrierë, por edhe drejt formimit të një njeriu qytetar të vërtetë. E kam marrë spuntin nga një takim i djeshëm te salla e COD-së në Kryeministri, ku zhvillohej një aktivitet; prezantohej ribotimi i veprave të Pëllumb Kullës. Isha ulur afër me Dritan Boriçin dhe menjëherë më shkoi ndër mend pse nuk është e mundur që njerëz të tillë, artistë të shquar, sportistë të shquar, të mund të shfrytëzohen si modele për të rinjtë e sotëm. Mendoj që ndoshta tek ajo pjesa e projekteve, këshillimi i karrierës apo ndoshta diçka tjetër, në një bashkëpunim midis ministrisë që drejton zonja Muzhaqi dhe Ministrisë së Arsimit, këta sportistë apo artistë të shquar të ftohen herë pas here në shkollat tona të mesme, pse jo edhe 9-vjeçare, për të bërë biseda, të cilat, në fund të fundit, i edukojnë të rinjtë me modele të vërteta të njerëzve të mirë dhe të suksesshëm,

profesionistë që vijnë nga fusha me impakt në shoqëri, se e dimë shumë mirë që një artist apo një sportist nuk është si një politikan, të cilin një pjesë e duan dhe një pjesë nuk e duan, përgjithësisht ka një dashamirësi që shkon deri afër 100%. Atëherë, le t'i shfrytëzojmë këta nëpërmjet një projekti apo një programi, ku të përfshihen të dyja ministritë. Kjo do edhe një lloj financimi. Bie fjala, që të rregullosh edhe udhëtimin e tyre drejt qendrave të caktuara arsimore në bashki të ndryshme, kërkohet një lloj shpenzimi, por nuk mendoj se është një shpenzim shumë i madh. Kam përshtypjen se ky projekt do të jetë me shumë ndikim tek të rinjtë, sepse nuk duhet të lëmë të sundojë modeli i atyre njerëzve që kanë disa zinxhirë në qafë, që bredhin me makina luksoze e të tjera; nuk do ta lëmë rininë të ndikohet nga ky lloj modeli, i cili është shumë negativ, por të përpiqemi t'i ofrojmë asaj modelin e suksesshëm, në fund të fundit, jo vetëm profesionistin e mirë, jo vetëm njeriun e suksesshëm publik, por edhe qytetarin e shkëlqyer, qytetarin e ndershëm. Këtë e kisha si sugjerim për ministren, që besoj se lidhet në njëfarë mënyre me buxhetin e vitit të ardhshëm.

Bora Muzhaqi – Nëse mundem, kam një koment të shkurtër për t'ju vlerësuar për sugjerimin tuaj. Në fakt, edhe komponenti i komisionit këtë ka si synim që ne të kemi mundësinë të diskutojmë mendime të ndryshme. Doja t'ju thosha se kemi filluar një iniciativë të tillë. Para një java apo dy javësh kemi qenë në Thumanë dhe fokusi kryesor ka qenë promovimi i sportistëve të mirë, më konkretisht, kemi pasur Izmir Smajlajn, kampion i Europës në atletikë, Erkand Qerimajn, kampion i Europës në peshëngritje dhe Eklent Kaçi, kampion i botës në bilardo dhe sportis elitari i zonës së Thumanës. Nga ky aktivitet që kryem, na rezultoi se të rinjtë vërtet ishin kuriozë që t'i shihnin dhe të flisnin me sportistët tanë të talentuar, prandaj qëndron edhe argumenti juaj, kështu që duhet të zhvillojmë edhe programe të mëtejshme, të cilat të mos jenë vetëm njëditore apo të zhvilluara në periudha periodike, por të jenë ndoshta edhe më të vazhdueshme dhe më të shpeshta.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, zoti Koçi!

Në fakt, edhe unë doja të shtoja këtu se para pak ditësh kam parë takimin e ministres së Arsimit së bashku me Adelina Mamaqin, një autore shumë e njohur e botimeve për fëmijë. Po kështu, takimet me sportistët Ministria e Arsimit dhe e Sportit i ka tashmë traditë dhe kampionët, si Luiza Gega, por edhe shumë të tjerë, që të mos i përmend të gjithë, vizitojnë shkollat dhe zhvillojnë bashkëbisedime me nxënësit. Natyrisht, duhet shumë më tepër dhe jam plotësisht dakord me zotin Koçi që të zgjerohen, të shtohen këto lloj takimesh, të përzgjidhen figurat, modelet

më të mira të shoqërisë, që të rinjtë dhe të rejat, nxënësit e shkollave të shohin dhe të ndjekin modelet më të mira, jo ata që na bllokojnë dyert e Parlamentit apo ata që ngjiten nëpër kangjella.

Nuk e di a ka pyetje të tjera nga kolegët.

Atëherë, nëse nuk ka pyetje të tjera, zonja Ministre, keni diçka të fundit apo i ezauruat të gjitha?

Bora Muzhaqi – Ju falënderoj për vëmendjen dhe dëshirën me të cilën i dëgjuat projektet e rinisë dhe mbetemi në bashkëpunim për projekte të mëtejshme.

Evis Kushi – Edhe ne ju falënderojmë shumë edhe për materialin që na keni sjellë në komision, i cili ishte shumë i zgjeruar, shumë i plotë, por edhe për prezantimin që i bëtë sot.

Kolegë, shumë faleminderit!

Mbledhjen e mbyllim këtu.

Mbledhja e radhës do të vijojë sipas kalendarit që...

Petro Koçi – Zonja nënkryetare, duhet të votohet buxheti në parim për rininë dhe për fëmijët.

Evis Kushi – Sipas kalendarit, kemi përcaktuar një datë tjetër për miratimin e buxhetit. Pra, po ta shikoni kalendarin, kemi një datë tjetër, që është parashikuar për të miratuar buxhetin.

Petro Koçi – Nuk e di, ndoshta duhet të pyesim këshilltarin e komisionit, por kam përshtypjen se ne i votojmë në parim, sipas institucioneve, pra, kur të vijë buxheti për arsimin, do të votojmë arsimin e kështu me radhë.

Evis Kushi – Kemi një kalendar që sapo e miratuam dhe aty është përcaktuar një datë tjetër për ta miratuar në parim dhe më pas nen për nen. Është caktuar dita e martë, datë 14.11.2023, ora 17:00.

Faleminderit të gjithë kolegëve!

Ditë të mbarë!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA

